



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 12907 prot.

Shkodër, më 26.6. 2025

VENDIM

Nr. 40, datë 25.06.2025

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 76, DATË 19.12.2024 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR ”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh” të ligjit nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.68/2017, “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit nr. 69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.10352, datë 18.11.2010, “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar; VKB-së nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, pika 1 shkronja g), sa i takon numrit total të punonjësve të Bashkisë Shkodër, sipas tabelës nr.11, pjesë përbërese e këtij vendimi.

2. Fondi i pagave për punonjesit shtesë të Bashkisë Shkodër përballohet nga fondet e trashëguara nga viti 2024 pjesë e buxhetit të bashkisë të vitit 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 30 vota

Vota Pro	30
Vota Kundër	1
Vota Abstenim	7
Zbardhur me datë	26.06.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI



Ishte
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2025

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	618	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	141	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	238	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	55	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		1052	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar	2141001	20	
TOTALI		1072	20

Bëhet
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2025

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	629	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	141	10
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	243	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	55	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		1068	30
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar	2141001	20	
TOTALI		1,088	30